



KRYEMINISTRI RAMA INSPEKTON KAMPUSIN E AFA-SË: ARKITEKTURË DHE KONCEPT ME STANDARDET E “WEST POINT”



» faqe 3



FA-TË, PJESË E “MILITARY ERASMUS”

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu kreu vizitë njëditore në strukturat e Bashkimit Evropian në Bruksel, ku zhvilloi një takim me Komisionerin për Mbrojtjen të Bashkimit Evropian, Andrius Kubilius. Për të cilin Ministri Vengu u shpreh se: “Nënshkrimi i dokumentit të Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe BE...”



» faqe 2



“GRATË, ARKITEKTET E VËRTETA TË SHOQËRISË”

Blerina Kuqi lindi më 14.05.1977. Formimin bazë e kreu në vendlindje dhe më pas ndoqi ëndrrën e saj, ku në vitin 1999 ndjek studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Histori - Filologji, Dega Histori. Më pas ndjek studimet në Universiteti jopublik “Albanian University”, Bachelor në Shkenca Juridike. Në vitin 2008, merr Titullin ‘Master’...



» faqe 6



GRUAJA USHTARAKE, LUFTËTARJA E PAEPUR E SFIDAVE TË KOHËS

Të qenit një grua ushtarake nuk është vetëm një profesion, por një mënyrë jetese që kërkon sakrifica të mëdha. Për një grua që është njëkohësisht ushtarake, bashkëshorte dhe nënë, balancimi i përgjegjësisë familjare dhe detyrimeve të shërbimit bëhet një sfidë e përditshme. Një grua që shërben në Forcat e Armatosura duhet të jetë e fortë fizikisht...



» faqe 8

FA-të, pjesë e “Military Erasmus”

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu kreu vizitë njëditore në strukturat e Bashkimit Evropian në Bruksel, ku zhvilloi një takim me Komisionerin për Mbrojtjen të Bashkimit Evropian, Andrius Kubilius.

Për të cilin Ministri Vengu u shpreh se: “Nënshkrimi i dokumentit të Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së në dhjetor 2024, na jep mundësinë të rrisim bashkëpunimin efektiv për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes”.

Më tej ai thekson se u njoh me përpjekjet e nisura nga Komisioneri për të fuqizuar komponentin e Mbrojtjes të Unionit dhe i kërkoi më shumë mbështetje dhe përfshirje të Shqipërisë në programet e BE-së për zhvillimin e kompleksit industrial të Mbrojtjes.

Ky partneritet strategjik do të forcojë përpjekjet e Shqipërisë për të luftuar kërcënimet hibride dhe kibernetike, ekstremizmin dhe do të rrisë më tej aftësitë e vendit tonë për sigurinë dhe mbrojtjen, duke kontribuar për një Europë më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

Shqipëria ka hedhur një hap të rëndësishëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke u bërë pjesë e programit “Military Erasmus”, i cili do t’u mundësojë kadetëve shqiptarë të trajnohen në mbi 10 akademi ushtarake të vendeve të Bashkimit Evropian.

Ky zhvillim u konfirmua gjatë takimeve të ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vengu me krerët e strukturave të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, në Bruksel.

Fokusi kryesor në këto takime ishte fuqizimi i industrisë ushtarake dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë sektor.



Gjatë takimit të ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu me Marie – Agnes Strack – Zimmermann, kryetare e Komisionit për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Parlamentin Evropian, u vlerësua kontributi i Shqipërisë në fushën e sigurisë në Evropën Juglindore.

“Teksa Shqipëria po përparon në mënyrë të gjithanshme në procesin e anëtarësimit, kërkova që vendi ynë të bëhet pjesë e mekanizmave të rinj të mbështetjes së industrisë ushtarake që



Bashkimi Evropian po zhvillon për vendet e saj anëtare”, - theksoi ministri Vengu.

Një tjetër takim i rëndësishëm u zhvillua edhe me Fergal O’Regan, drejtuesin e Kolegjit Evropian për Sigurinë dhe Mbrojtjen, ku u diskutua mbi ngritjen e kapaciteteve akademike, shkëmbimin e përvojave në fushën e kërkimit dhe inovacionit si dhe pasurimin e kurrikulave të trajtimit ushtarak.

O’Regan mikpritri përfshirjen e Shqipërisë në “Military Erasmus”, gjë që hap dyert për një formim më cilësor dhe të standardizuar për kadetët shqiptarë në akademitë prestigjioze të BE-së.



Starton Kursi XV i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen

Ka nisur, në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Forcat e Armatosura shqiptare, institucionet e sigurisë në vend si dhe përfaqësuesve të vendeve të NATO-s.

Në ceremoninë e nisjes së këtij programi, që është kursi më i lartë në piramidën e arsimit në karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura, mori pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes Blerina Abrazhda, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Altin Kurti, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, si dhe komandantë dhe drejtorë në FA.

Në fjalën e saj, zëvendësministria Abrazhda, vuri në dukje rëndësinë e këtij kursi për përgatitjen e atyre që ajo i konsideroi si udhëheqës të nesërme: “Ky kurs nuk është thjesht një trajnim akademik, por një platformë vendimtare për thellimin e njohurive, nxitjen e të menduarit strategjik, shkëmbimin e ideve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve të sigurisë dhe mbrojtjes. Ai bashkon oficerë dhe zyrtarë të rangut të lartë nga Shqipëria, rajoni, vendet e NATO-s dhe ato partnere, duke përforcuar angazhimin tonë të përbashkët për sigurinë dhe stabilitetin. Siguria dhe mbrojtja janë shtylla themelore e çdo shteti sovran dhe të qëndrueshëm. Në një epokë ku sfidat e sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse, ne kemi nevojë për udhëheqës dhe ekspertë të përgatitur mirë, të cilët mund



të analizojnë, parashikojnë dhe reagojnë në mënyrë efektive ndaj kërcënimeve të vazhdueshme”, - u shpreh zëvendësministria Abrazhda.

Në Kursin XV të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen marrin pjesë 18 ushtarakë të lartë nga Shqipëria, Kosova, Kroacia,

Gjeorgjia, Hungaria, Italia, Turqia si dhe civilë profesionistë të shquar nga institucione të ndryshme të sigurisë në vend.

Programi jep njohuri dhe trajnim analitik për probleme të Mbrojtjes dhe Sigurisë në nivelin kombëtar, rajonal e më gjerë.

Kursi ka si qëllim aftësimin e ushtarakëve

dhe civilëve të niveleve strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë së vendit dhe atyre analoge të vendeve të tjera. Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, zhvillohet në gjuhën angleze, ka një kohëzgjatje rreth tremujore dhe përfundon më 23 maj 2025.

KRYEMINISTRI RAMA INSPEKTON KAMPUSIN E AFA-SË: ARKITEKTURË DHE KONCEPT ME STANDARDET E “WEST POINT”

Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura, një investim i shtrirë në një hapësirë prej 10 hektarësh, i cili po ndërtohet sipas modelit të një prej akademive më të mira në SHBA, “West Point”, është drejt finalizimit të fazës së parë të projektit. I konceptuar me standardet më të larta të NATO-s, kampusi do të ofrojë gjithçka bashkëkohore, që nga godina mësimore, konvikti, qendra shëndetësore, kinemaja, palestra, pishina e mbyllur, terrenet sportive dhe ato të stërvitjes ushtarake në natyrë, si poligonet, pista e vrapit, kulla e alpinizmit, etj.

Akademia e re do të ketë si fillim 300 studentë dhe degë të reja, përfshirë dhe Inteligjencën Artificiale, ku do të ketë diploma të përbashkëta me Universitetin Politeknik në degë të caktuara, por dhe binjakëzime me akademitë e vendeve aleate të NATO-s.

Kryeministri Rama ishte sot në kantier për të ndjekur ecurinë e punimeve, së bashku me ministrin e Mbrojtjes Pirro Vengu.

“Në këtë repart të Tufinës, praktikisht jemi në një njollë prej 45 ha, 10 ha janë të dedikuara tërësisht për Akademinë e re të Forcave të Armatosura. Masterplani përfshin 3 faza, është duke u finalizuar pjesa e parë, e cila parashikon një objekt kryesor për Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes, që është shtylla kryesore e akademisë, ku kemi rreth 300 studentë, të cilët do të akomodohen që në sezonin e ardhshëm me përfundimin e punimeve.

Përfundimi i punimeve parashikohet nga inxhinierët brenda korrikut. Kemi rehabilituar tërësisht një godinë të vjetër të repartit, ku do jetë dhe mensa, e cila ka të gjitha kapacitetet për tërësinë e stafit dhe tërësinë e personelit dhe të studentëve që në fazën e parë dhe do vijnë pastaj me godinën kryesore, e cila është në përfundim e sipër. Masterplani parashikon në fazën e dytë përfundimin edhe të të gjithë elementëve mbështetës, fushat sportive, konviktin, të cilin jemi duke e dizajnuar me arkitektët ndërkombëtarë, në mënyrë që e gjithë akademia të ketë mundësi më tej që të rrisë edhe numrin e studentëve”, - shpjegoi ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, i cili foli gjithashtu për rekrutimet e reja në Akademi.

“Vitin aktual, në shtator, patëm një sezon shumë të mirë rekrutimesh, rreth 1100 aplikantë, prej të cilëve, me një përzgjedhje shumë strikte, vetëm 87 janë pranuar, që është një normë seleksionimi shumë e rreptë. Por kjo tregon që ka kërkesa të mëdha për t’u atashuar në programet e akademisë, programet bachelor dhe programet master, ku kemi sivjet edhe programe për mbrojtjen kibernetike, me



“PËRFUNDIMI I PUNIMEVE PARASHIKOHET
NGA INXHINIERËT BRENDË KORRIKUT. KEMI
REHABILITUAR TËRËSISHT NJË GODINË
TË VJETËR TË REPARTIT, KU DO JETË DHE
MENZA, E CILA KA TË GJITHA KAPACITETET
PËR TËRËSINË E STAFIT DHE TËRËSINË E
PERSONELIT DHE TË STUDENTËVE QË NË
FAZË TË PARË DHE DO VIJOJNË PASTAJ
ME GODINËN KRYESORE, E CILA ËSHTË NË
PËRFUNDIM E SIPËR.

shumë interes edhe nga personeli civil. Ka mjaft interes edhe nga personel të të gjitha subjekteve të tjera ligjzbatuese që janë të interesuar të gjenerojnë kapacitete për mbrojtjen kibernetike, dhe kësaj radhe, për herë të parë kemi programin për Inteligjencën Artificiale, sepse është shumë e domosdoshme për të gjithë programet që kanë të bëjnë me industrinë ushtarake, me sistemet e mbrojtjes, simulatorët, gjithashtu edhe me Shkollën e re të Aviacionit, që siç

e dini, kemi në plan ta ndërtojmë, patjetër që elementët e AI-së do të integrohen”, - u shpreh ai.

Ndërsa, sa i takon harmonizimit të projektit të kampusit me mjedisin përreth, ministri Vengu tha se: “Besoj se është nga të vetmet kampuse në Republikën e Shqipërisë që ka edhe elementin e natyrës tërësisht dominues në tërësinë e pronës dhe do të përqipemi që ta ketë gjithmonë në çdo fazë të zhvillimit. Këtë kemi biseduar dhe me

arkitektë ndërkombëtarë, që t’i përmbahemi elementit natyror, që të mos kemi struktura që pushtojnë, por struktura që integrohen dhe janë me intensitet të ulët. Kemi dhe burime uji që vijnë nga mali, të cilat do të përqipemi t’i integrojmë po në këtë mënyrë, sepse është ujë i pastër dhe është vënë në funksion për përdorime ushtarake edhe në të kaluarën, dhe do të përqipemi ta integrojmë në natyrë dhe në funksionalitet të të gjithë akademisë”, - vijoi më tej ai. Nga ana e tij, kryeministri Rama tha se, ndonëse afatet e parashikuara për përfundimin e plotë të kampusit janë të rëndësishme, kryesore mbetet cilësia. “Unë them në të gjitha rastet të kapim patjetër korrikun, por me cilësi. Në tetor, për vitin e ri akademik studentët patjetër do të kenë gati auditorët e rinj, ashtu siç dhe iu kemi premtuar. Është gjithë ky investim, duhet të jetë perfekt. Arkitektura është punuar me kujdes dhe bukur. Hapësirat janë të konsiderueshme për numrin e studentëve gjithmonë në rritje. Ky kampus do të jetë një pikë referimi për të gjithë ushtrinë”, - u shpreh kryeministri Rama në fund të inspektimit të kampusit, investim i Ministrisë së Mbrojtjes.





Grup - Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë nis stërvitjen “Mburoja e Arbrit-25”

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, mori pjesë në nisjen e Grup - Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) në stërvitjen dislokuese të koduar “Mburoja e Arbrit - 25”, e cila zhvillohet në rajone të ndryshme të vendit.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi faktin se ky kapacitet kombëtar nën monitorim nga NATO, në vitin 2022, në stërvitjen “Biza - 22”, plotësoi kriteret për kategorinë e gatishmërisë “Combat Ready”, (i gatshëm për luftë), një certifikim që do të vazhdojë të ketë rëndësi për Forcat e Armatosura për katër vitet në vazhdim: “Stërvitjet janë mjeti më i mirë, përveç luftës, për të ‘testuar’ nëse personeli, pajisjet dhe procedurat ndërveprojnë siç duhet dhe krijojnë bashkëveprimin e nevojshëm në operacion. Prandaj, kjo stërvitje e koduar “Mburoja e Arbrit-25” synon integrimin dhe ndërveprueshmërinë e të gjithave strukturave në përbërje të GBKL-së, si një strukturë e organizuar për detyrë, që formohet nga: bashkimi i kapaciteteve të luftimit, mbështetja me luftim, si dhe mbështetja me shërbime të luftimit, të cilat gjenerohen nga strukturat e Forcës Tokësore dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, - u shpreh në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni, ministri i Mbrojtjes.

Ministri Vengu përshëndeti integrimin e kapaciteteve moderne



në këtë stërvitje siç janë: dronët, sistemet e komunikimit me kriptim të lartë dhe armët me standarde të NATO-s, duke konfirmuar kështoj grup-batalionin si një strukturë operacionale: “Pavarësisht kësaj, - theksoi më tej ministri Vengu, - jam krejt i vetëdijshëm që pajimet

tuaja personale, mjetet, sistemet, fuqia e zjarrit, në situatën aktuale të kërcënimeve, qoftë në rajon, qoftë edhe në kontinent, janë tërësisht të pamjaftueshme. Këtu duhet t’i themi të vërtetën vetes, ta shohim të vërtetën me transparencë dhe t’i dalim për zot të gjitha sfidave që qeveria na ka vënë. Duhet padyshim të ecim me shpejtësi drejt një riarmatimi të mirëfilltë, qoftë nga pikëpamja e fuqisë së zjarrit, qoftë nga pikëpamja e sistemeve mbështetëse dhe të sigurisë në mënyrë që ndërveprueshmëria juaj në situata operacionale me aleatët të jetë 100%”, - u shpreh ministri Vengu.

Ai theksoi gjithashtu angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të qeverisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe trajtimit të ushtarakëve, duke u përqendruar në rritjen e kapaciteteve operacionale, modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve, si dhe investimet në zhvillimin e sistemeve të komunikimit dhe mbështetjes për Forcën Tokësore.

Kjo stërvitje dislokuese e GBKL i paraprin përgatitjeve për pritjen e stërvitjes së NATO “Defender 2025”, në vendin tonë dhe pjesëmarrjen në stërvitjet e tjera të NATO: “Immediate Response – 25”, “Suber Guardian – 25” dhe “Swift Response – 25”, ku Forca Tokësore dhe Grup-Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë ka peshën kryesore.



Anija “Butrinti”, operacion shpëtimi për 36 emigrantë në detin Egje

Gjatë patrullimit në Detin Egje, anija Butrinti realizoi një operacion shpëtimi (SAR), duke i ardhur në ndihmë një gomoneje me 36 emigrantë nga Lindja e Mesme, mes tyre 12 fëmijë, që ishte nisur nga Çeşme me destinacion ishullin e Chios-it.

Në përfundim të operacionit, emigrantët u morën nga Roja Bregdetare turke, e cila falënderoi palën shqiptare për ndihmën e dhënë nga anija Butrinti. Forca Detare vijon kontributin e saj në këtë mision të rëndësishëm, pjesë e Grupit të 2-të Detar të NATO-s në operacionin “Sea Guardian”, duke garantuar jetën në det dhe menaxhuar emigrimin e paligjshëm në zonën e detit Egje.



“Dhuro gjak, shpëto jetë!”

Me shumë solidaritet studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura iu bashkuan thirrjes së dhurimit të gjakut për njerëzit në nevojë, nismë e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Shpresojmë që kjo iniciativë të frymëzojë dhe të tjerët që të dhurojnë gjak!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë kanë luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe ndryshimin e botës, duke kontribuar në çdo fushë të jetës shoqërore, kulturore, politike dhe shkencore. Përmes guximit, mençurisë dhe vizionit të tyre, ato kanë sfiduar normat ekzistuese dhe kanë hapur rrugë për brezat që do të vijnë.

Gruaja - Nëna, Shtylla e Jetës

Gruaja dhe nëna janë dy figura të pandashme, që përfaqësojnë forcën, sakrificën dhe dashurinë më të madhe në jetë. Gruaja është zemra e familjes, ndërsa nëna është shpirti i saj. Ajo që e bën gruan të veçantë është aftësia e saj për të dhënë jetë dhe për të sakrifikuar gjithçka për fëmijët e saj.

Gruaja - Shtylla e Shoqërisë

Që nga kohërat e lashta, gruaja ka qenë një figurë e rëndësishme në familje dhe në shoqëri. Ajo nuk është vetëm një bashkëshorte dhe një nënë, por edhe një mbështetje për të gjithë ata që e rrethojnë. Me mençurinë, butësinë dhe forcën e saj, ajo ndikon në edukimin e brezave të ardhshëm dhe në ndërtimin e një shoqërie më të mirë.

Nëna - Dashuria dhe Sakrifika e Pafundme

Kur një grua bëhet nënë, ajo e vendos fëmijën e saj mbi gjithçka. Nëna nuk lodhet kurrë duke u kujdesur për fëmijët e saj, nuk mërzitet duke sakrifikuar dhe nuk kërkon asgjë në këmbim. Ajo është gati të bëjë çdo gjë për të siguruar që fëmijët e saj të jenë të lumtur dhe të kenë një jetë më të mirë.

Forca e Gruas dhe Dashuria e Nënës

Gruaja është e fortë, por njëkohësisht edhe e butë. Ajo mund të përballojë vështirësi të mëdha, por gjithmonë ruan dashurinë dhe ngrohtësinë për familjen e saj. Si nënë, ajo është shtylla e shtëpisë, si grua, ajo është drita që ndriçon rrugën e jetës. Gruaja dhe nëna janë dy figura të shenjta që meritojnë respekt dhe dashuri çdo ditë. Pa to, bota nuk do të kishte jetë, nuk do të kishte dashuri dhe nuk do të kishte shpresë.

Të Jesh Grua Përballë Maskilizmit të Kohës

Të jesh grua ka qenë gjithmonë një sfidë, por të jesh grua në një shoqëri të dominuar nga maskilizmi është një betejë e përditshme. Maskilizmi është një realitet që shumë gra e përballin ende sot në familje, në punë dhe në jetën e përditshme. Pavarësisht përparimeve në drejtim të barazisë gjinore, mentaliteti patriarkal vazhdon të mbetet një pengesë për gratë që kërkojnë të jetojnë të lira dhe të barabarta me burrat.

Gruaja dhe Lufta për Barazi

Historikisht, gratë janë parë si qenie të dobëta, të destinuara për t'u kujdesur për shtëpinë dhe familjen. Ato janë përjashtuar nga vendimmarrja dhe nga mundësitë e barabarta në shoqëri. Edhe sot, në shumë vende, gratë përballen me diskriminim, pagë më të ulët, mungesë mundësish dhe paragjykime të shumta.

Sfida e Gruas Moderne

Në ditët e sotme, gruaja nuk është më vetëm një amvisë; ajo është lidere, profesioniste, aktiviste dhe një forcë e fuqishme në çdo fushë të jetës. Por edhe pse ka arritur suksese të mëdha, ajo ende duhet të luftojë kundër mendësisë që e sheh si inferiore. Në punë, shpesh nuk merret seriozisht, në familje pritet të sakrifikojë më shumë se burri, dhe në shoqëri gjykohet për zgjedhjet e saj.

Si Mund të Luftohet Maskilizmi?

Edukimi është çelësi për të ndryshuar mentalitetin. Sa më shumë të edukohet shoqëria për barazinë, aq më pak vend do të ketë maskilizmi.

Gratë duhet të mbështesin njëra-tjetrën dhe të ngrihen kundër padrejtësive.

Gratë nuk duhet të ndihen të detyruara të ndjekin rolet tradicionale nëse nuk duan. Secila ka të drejtë të zgjedhë vetë rrugën e saj. Gratë duhet të kenë një zë më të fortë në politikë, ekonomi dhe shoqëri, për të ndryshuar sistemin që shpesh i mënjanon ato.

Të jesh grua përballë maskilizmit nuk është e lehtë, por gratë janë të forta dhe të guximshme. Historia ka treguar se asgjë nuk mund t'i ndalë ato kur vendosin të ndryshojnë botën. Maskilizmi nuk mund të zhduket brenda natës, por me edukim, guxim dhe mbështetje, shoqëria mund të bëhet më e drejtë dhe më e barabartë për të gjithë. Një grua e fortë nuk është ajo që nuk ka frikë, por ajo që nuk dorëzohet kurrë!

Unë jam Nënë

Unë jam nënë... dhe ky është statusi më i bukur që mund të kem. Nuk ka fjalë që mund të përshkruajë ndjenjën e të sjellit të një fëmijë në jetë, atë dashuri të pastër që buron nga shpirti, sakrificat e panumërta dhe lumturinë që vetëm një nënë mund ta ndiejë.

Që në momentin kur dëgjova për herë të parë rrahjet e zemrës së fëmijës tim, e kuptova se jeta ime nuk do të ishte më e njëjtë. Unë nuk jetoj më vetëm për veten time, por për të. Ndihej e lodhur, por kurrë nuk dorëzohem. Ndihej e sfiduar, por gjithmonë e gatshme për të luftuar.

Unë jam nënë... dhe kjo do të thotë të zgjohem netëve për të qetësuar fëmijën tim, të buzëqesh edhe kur jam e

NUK KA DITË TË NËNËS, POR KA JETË KUSHTUAR NËNËS



lodhur, të jap gjithçka pa pritur asgjë në këmbim. Të jem një përqaftim kur ka nevojë, një krah i fortë kur bie, një zë i butë që e udhëzon në jetë.

Unë jam nënë... dhe kjo do të thotë të jem e fortë edhe kur zemra më thyhet. Të fshij lotët e mi në heshtje, por të fshij çdo lot nga faqet e fëmijës tim.

Të jem shpresa, dashuria dhe mbrojtja e tij.

Unë jam nënë... dhe kjo është dhurata më e bukur që jeta më ka bërë.

Jetës Mirënjohëse...

Nëna ime ka qenë drita që më ka udhëhequr, krahua ku jam mbështetur dhe zemra që ka rrahur gjithmonë për mua. Njeriu që më mësoi çfarë do të thotë të duash pa kushte. Fjalët nuk mjaftojnë për ta falënderuar për netët pa gjumë, për dorën që më ka mbajtur kur isha e dobët dhe për forcën që më ka dhënë kur më duhej më shumë.

Mirënjohëse që jeta më bëri nënë!

Unë jam nënë, dhe e kuptoj edhe më shumë çdo sakrificë dhe çdo lot të derdhur fshehtas të nënës time. Tani e di sa e vështirë, por edhe sa e bukur është të jesh nënë. Tani e di çfarë do të thotë të vësh një tjetër qenie mbi veten tënde, të ndiesh frikën më të madhe për të, dhe një dashuri të pafund që s'ka fjalë që ta përshkruajë.

Jeta me këtë përballje na mësoi se nënat nuk janë thjesht gra që lindin fëmijë; ato janë engjëjt që krijojnë jetë, sakrifikojnë, japin dashuri dhe formojnë botën.

Ky është cikli më i bukur i jetës, të duash dhe të japësh.

"Nëna" në buzët e fëmijës

Fjalët nuk mjaftojnë për ta përshkruar madhësitë e gjithësisë së saj, por një gjë e di me siguri, ajo është dhe do të mbetet gjithmonë engjëlli ynë mbrojtës, njeriu më i dashur dhe më i shtrenjtë në këtë botë.

"Nënë", e thjeshta deri në dhimbje, vetëmohuesja deri në madhësi. Kur një fëmijë shqipton për herë të parë këtë fjalë, ai nuk thotë vetëm një emër, por thërret gjithë botën e tij, personin që i qëndron pranë ditë e natë, që e ushqen, e përqafton dhe e mbrojnë me gjithë shpirtin e saj. Kjo fjalë e bekuar nuk është thjesht një fjalë, është një ndjenjë, një lidhje e pazëvendësueshme, një dashuri e pamatshme që zgjat gjithë jetën.

Nëna - Drita e Jetës

Nëna është heroína e heshtur e çdo familjeje, e cila për të siguruar që fëmijët e saj të jenë të lumtur, harron 'veten'. Edhe kur është e lodhur, buzëqesh për të mos shqetësuar askënd, dhe kur ka dhimbje, e fsheh atë pas një përqaftimi të ngrohtë, është drita që ndriçon jetën, pa kërkuar asgjë në këmbim.

"Nëse i kthen kurrizin nënës, as gjarpri nuk të mban në gj"

Nëse një njeri nuk di të respektojë dhe të dojë nënën e tij, ai nuk do të gjejë dashuri as te njerëzit e tjerë, sepse edhe krijesa më e rrezikshme ka një instinkt për të mbrojtur të vegjlit e saj, por një njeri i tillë e humb edhe këtë mbështetje. Ai bëhet i vetmuar dhe i padashur, sepse ka harruar vlerat më të rëndësishme të jetës: respektin, dashurinë dhe mirënjohjen. Nëna është thesari më i çmuar që kemi. Duhet ta duam dhe ta respektojmë, sepse ajo është e vetmja që do të na qëndrojë pranë gjithmonë. Kush nuk e vlerëson nënën, humbet më shumë se gjithçka tjetër në jetë.

Të Sakrifikosh si Nënë, në heshtje...

Nuk ka dashuri më sublime se dashuria e një nëne për fëmijën e saj. Nuk ka asgjë që një nënë nuk do të bënte për fëmijën e saj. Heq dorë nga ëndrrat e saj dhe madje të durojë dhimbje, vetëm që fëmija i saj të jetë i lumtur.

Një fjalë e thjeshtë, një person i pazëvendësueshëm dhe një dashuri e pafund. Kjo është nëna, dhurata më e çmuar që kemi në jetë. Nëse ka një person në botë që meriton çdo fjalë të bukur, çdo falënderim dhe çdo përqaftim, ajo është nëna.

Të jesh nënë është misioni më i bukur dhe më fisnik në jetë. Prandaj, t'i duam nënat me gjithë zemër, sepse janë thesari më i çmuar që kemi!

Gratë dhe nënat meritojnë vëmendje dhe vlerësim gjatë gjithë vitit, jo vetëm çdo 8 Mars. Dita Ndërkombëtare e Gruas është një mundësi për të reflektuar mbi arritjet e grave dhe për të rritur ndërgjegjësimin për barazinë gjinore, por çdo ditë është e përshtatshme për të shprehur mirënjohjen dhe dashurinë ndaj nënave. Është e rëndësishme të njohim dhe vlerësojmë të gjitha gratë që kontribuojnë në shoqëri në mënyra të ndryshme, qoftë si nënat, motrat, vajzat, apo profesionistet në fushat e tyre. Një shoqëri që respekton dhe vlerëson gratë është një shoqëri më e drejtë dhe më e zhvilluar.

“GRATË, ARKITEKTET E VËRTETA TË SHOQËRISË”



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Blerina Kuqi lindi më 14.05.1977. Formimin bazë e kreu në vendlindje dhe më pas ndoqi ëndrrën e saj, ku në vitin 1999 ndjek studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti Histori - Filologji, Dega Histori. Më pas ndjek studimet në Universiteti jopublik “Albanian University”, Bachelor në Shkenca Juridike.

Në vitin 2008, merr Titullin ‘Master’ në Histori, dhe në vitin 2021 ‘Doktor në Histori’. Profesoreshtë Blerina ka dhënë kontributin e saj ndër vite si: Lektore e jashtme në Universitetin jopublik “New York”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, për Historinë e shtetit shqiptar dhe Antropologjinë e së drejtës, Akademia e Studimeve Albanologjike, marrëdhënie me publikun/koordinatore e ASA-s. Qendra Sociale “Don Bosko”, Tiranë, si Mësuese e lëndëve histori – gjeografi. Universiteti publik “Aleksandër Moisiu”, Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Turizmit, Durrës. Shkolla publike “Fan S. Noli”. Universiteti jopublik “Albanian University”, Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Shkencave Politike, Berat. Gjimnazi jopublik “Faik Konica”, përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Shoqërore, shkolla jopublike “Nobel”. Instituti Arsimor “Wilson”, përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Shoqërore Shkolla jopublike “Horizont”. Prej disa vitesh ushtron profesionin e saj si pedagoge në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave të Komunikimit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Profesoreshtë Blerina, ju falënderoj që pranuat të ndanit eksperiencën tuaj si nënë dhe pedagoge me lexuesin e shtypit ushtarak në ditën ndërkombëtare të grave, bashkimi i të cilave solli të drejtat e mohuara si dhe 7 marsin, ditës kur mbledhemi njëzëri për të falënderuar me përvullje mësimsdhënësit tanë, për punën e tyre fisnike. Ju jeni një grua me dy role shumë të rëndësishme, pedagoge dhe nënë. Si e përshkruani përvojën tuaj duke i balancuar të dyja?

Të qenit nënë më ndihmon të kuptoj më mirë, si dhe të jem më e ndjeshme ndaj nevojave dhe kërkesave të studentëve. Por nga ana tjetër përpiqem të ruaj një distancë korrekte profesionale, që më lejon një mbarëvajtje të procesit mësimsor. Gjetja e një ekuilibri të tillë ka ardhur me përvojën ndër vite dhe është në një përmirësim të vazhdueshëm. Çdo ditë është një sfidë e re si për studentët, ashtu edhe për mua.

A ka ndonjë përvojë nga jeta akademike që ju ka ndihmuar në prindërim? Po si nënë, a ju ka ndihmuar në punën tuaj si pedagoge?

Kontakti i vazhdueshëm me të rinjtë të bën të kuptosh më mirë edhe fëmijët e tu, vështirësitë që mund të kenë ata në procesin e të nxënës. Ana profesionale akademike të ndihmon t’i orientosh fëmijët në mënyrën e të mësuarit, t’i ndihmosh si të punojnë në mënyrë të pavarur, si të jenë kërkues ndaj vetes, krijues në realizimin e detyrave dhe të nxisës dëshirën për dijen. Të qenit nënë të bën të kuptosh më mirë se, vështirësitë që i ke hasur në familje janë edhe për studentët e tu. Në këtë mënyrë përpiqesh që me durim dhe këmbëngulje të ndikosh tek ata, por pa imponuar.

Cila është sfida më e madhe që hasni në balancimin e këtyre dy roleve?



KONTAKTI I VAZHDUESHËM ME TË RINJTË TË BËN TË KUPTOSH MË MIRË EDHE FËMIJËT E TU, VËSHTIRËSITË QË MUND TË KENË ATA NË PROCESIN E TË NXËNIT. ANA PROFESIONALE AKADEMIKE TË NDIHMON T’I ORIENTOSH FËMIJËT NË MËNYRËN E TË MËSUARIT, T’I NDIHMOSH SI TË PUNOJNË NË MËNYRË TË PAVARUR, SI TË JENË KËRKUES NDAJ VETES, KRIJUES NË REALIZIMIN E DETYRAVE DHE TË NXISËSH DËSHIRËN PËR DIJEN. TË QENIT NËNË TË BËN TË KUPTOSH MË MIRË SE, VËSHTIRËSITË QË I KE HASUR NË FAMILJE JANË EDHE PËR STUDENTËT E TU.

Gjatë viteve dhe eksperiencave të shumta me breza të ndryshëm kam mësuar të ruaj një ekuilibër të tillë: të mos jem shumë nënë në klasë dhe njëkohësisht të mos jem shumë mësuese në shtëpi. Balancimi mes të qenit mësuese dhe nënë është një sfidë e madhe, sepse të dyja rolet kërkojnë shumë

përkushtim emocional, intelektual dhe fizik. Një nga sfidat kryesore është menaxhimi i kohës, të sigurohesh që po u jep nxënësve gjithë vëmendjen dhe energjinë e duhur në klasë, ndërkohë që ke edhe kohë cilësore për fëmijët e tu në shtëpi. Një tjetër sfidë është shterimi emocional si mësuese, je shpesh



një figurë mbështetëse për nxënësit, gjë që kërkon shumë durim dhe empati, dhe kjo mund të të lërë pa energji kur kthehesh në shtëpi. Po ashtu, ka edhe ndjenjën e fajit, ndonjëherë ndihesh sikur po neglizhon nxënësin për tjetrin. Por, nga ana tjetër, ka edhe shumë përparësi! Duke qenë mësuese, mund të sjellësh përvoja të vlefshme në rritjen e fëmijëve të tu dhe anasjelltas, të kuptosh më mirë nevojat dhe ndjeshmëritë e nxënësve duke qenë vetë prind.

Si arrini të krijoni një ekuilibër mes punës dhe jetës familjare?

Për çdo njeri është shumë e rëndësishme të bëjë punën që e ka pasion. Unë jam një nga ato dhe për këtë jam shumë e lumtur. Mendoj se familja dhe puna janë dy gjëra që i japin kuptim jetës së një njeriu. Një jetë familjare e shëndetshme të krijoj qetësinë shpirtërore për ta kryer detyrën tënde sa më mirë. Ashtu si dhe një punë që e bën me dëshirë dhe për të cilën ke investuar kohë, arsimim, mund e sakrifica të jep motivin që të nisësh ditën me optimizëm dhe shpresë, sepse ti kupton se përpjekjet e tua janë shpërblyer. E bukura e profesionit që bëj është se të aftëson të menaxhosh situata të ndryshme me qetësi, të njohësh njerëzit më plotësisht dhe të përpiqesh të nxjerrësh më të mirën prej tyre.

Çfarë mesazhi keni për gratë që përballen me sfidën e balancimit mes karrierës dhe familjes?

Do t'u thosha që kurrë të mos heqin dorë nga ambiciet e tyre profesionale. Për një grua gjërat nuk janë të thjeshta, pasi asaj i duhet të përballen me disa detyra njëkohësisht, të jetë një grua dhe nënë e përkushtuar dhe po ashtu të realizojë dëshirat e saj për karrierë. Nuk them që është e lehtë, por as e pamundur. Do të doja të theksoja se një rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe bashkëshorti, përkrahja e të cilit është vendimtare. Mendoj se emancipimi i shoqërisë shqiptare sot, duket tek mbështetja që bashkëshortët u japin grave të tyre për t'u rritur në karrierë. Po ashtu jam e vetëdijshme se mjaft grave dhe vajzave u duhet të luftojnë fort për thyer paragjykimet patriarkale dhe për të fituar në konkurrencën me meshkujt. Ato nuk duhet të ndalin së ëndërruari. Një grua e përmbushur profesionalisht është e tillë edhe në familje e shoqëri.

Si ndryshon përvoja e mësimdhënies tek studentët ushtarakë në krahasim me studentët civilë?

Mësimdhënia për studentët ushtarakë ndryshon nga ajo për studentët civilë në disa aspekte kryesore, duke përfshirë disiplinën, metodologjinë e mësimdhënies, strukturën e programit dhe pritshmëritë akademike. Studentët ushtarakë zakonisht ndjekin një regjim më të rreptë disiplinor, me rregulla të qarta mbi sjelljen, pjesëmarrjen dhe angazhimin akademik. Ata janë të mësuar me hierarkinë dhe disiplinën, gjë që i bën më të fokusuar dhe të organizuar. Studentët civilë mund të kenë më shumë fleksibilitet në mënyrën se si e qasin mësimin, duke reflektuar më shumë në mënyrë individuale dhe shpesh duke kërkuar qasje më krijuese. Studentët ushtarakë zakonisht ndjekin një regjim më të

rreptë disiplinor, me rregulla të qarta mbi sjelljen, pjesëmarrjen dhe angazhimin akademik. Ata janë të mësuar me hierarkinë dhe disiplinën, gjë që i bën më të fokusuar dhe të organizuar. Në institucionet ushtarake, mësimdhënia shpesh përfshin qasjen e bazuar në skenarë praktikë, ku studentët mësojnë përmes rasteve reale që lidhen me fushën e tyre. Ka më shumë stërvitje praktike, simulime dhe ushtrime strategjike sesa thjesht teori. Në institucionet civile, metoda e mësimdhënies është më e hapur dhe mund të përfshijë debate, diskutime kritike dhe analiza të thelluara teorike, pa pasur domosdoshmërisht një strukturë të ngurtë disiplinore. Ushtarakët zakonisht kanë një motivim të lartë për të mësuar, sepse edukimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre profesionale. Ata kanë përkushtim dhe ndjenjë të fortë të detyrës, duke qenë se edukimi i tyre ndikon në karrierën dhe avancimin në ushtri. Kam mësuar shumë gjëra të reja dhe për këtë i falënderoj.

A ka ndonjë aspekt të veçantë të komunikimit me studentët ushtarakë?

Ajo që vlerësoj tek studentët ushtarakë është disiplina e lartë që reflektohet edhe në komunikim. Por si në çdo marrëdhënie njerëzore duhet një kujdes në mënyrën e komunikimit, si nga ana

“ PËR NJË GRUA GJËRAT NUK JANË TË THJESHTA, PASI ASAJ I DUHET TË PËRBALLET ME DISA DETYRA NJËKOHËSISHT, TË JETË NJË GRUA DHE NËNË E PËRKUSHTUAR DHE PO ASHTU TË REALIZOJË DËSHIRAT E SAJ PËR KARRIERË. NUK THEM QË ËSHTË E LEHTË, POR AS E PAMUNDUR. DO TË DOJA TË THEKSOJA SE NJË ROL TË RËNDËSISHËM NË KËTË PROCES KA EDHE BASHKËSHORTI, PËRKRAHJA E TË CILIT ËSHTË VENDIMTARE. MENDOJ SE EMANCIPIMI I SHOQËRISË SHQIPTARE SOT, DUKET TEK MBËSHTETJA QË BASHKËSHORTËT U JAPIN GRAVE TË TYRE PËR T’U RRRITUR NË KARRIERË.

e pedagogut ashtu edhe nga studentët. Në akademitë ushtarake, komunikimi shpesh është më formal sesa në universitetet civile. Studentët janë të mësuar t'u drejtohen pedagogëve me respekt dhe sipas normave të përcaktuara nga protokollet ushtarake. Përdorimi i titujve zyrtarë dhe ruajtja e një toni profesional është i rëndësishëm për të ruajtur strukturën e disiplinës. Studentët ushtarakë janë mësuar të respektojnë autoritetin. Komunikimi me studentët ushtarakë kërkon qartësi, strukturë dhe disiplinë, por njëkohësisht duhet të krijojë hapësirë për mendim kritik dhe dialog të hapur. Pedagogët që japin mësim në institucione ushtarake duhet të jenë fleksibël për të përshtatur stilin e tyre të komunikimit, duke respektuar rregullat e institucionit dhe pritshmëritë e studentëve.

Cilat janë sfidat më të mëdha që hasni si pedagogë në këtë mjedis?

Misioni ynë është të përgatisim studentët që do të jenë liderë të së ardhmes, prandaj dhe një sfidë e përditshme është ndërtimi dhe formësimi i karakterit të tyre si një dimension i rëndësishëm për një drejtues ushtarak.

Çfarë ju motivon më shumë në punën tuaj me studentët ushtarakë?

Ndjej shumë kënaqësi kur pyes studentët, pse kanë zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura dhe shumica e tyre thonë se është një zgjedhje personale, e bërë nga dëshira për të dhënë kontributin e tyre në mbrojtjen e atdheut, si dhe siguria për një karrierë brenda Forcave të Armatosura. Gjej rastin të falënderoj edhe të gjithë studentët e ardhur nga Kosova, të cilët i vlerësoj për përkushtimin e tyre akademik dhe ushtarak. Ajo që më motivon në punën time të përditshme është përgatitja e elitës ushtarake, që do të ketë fatet e sigurisë kombëtare, por edhe do të përfaqësojë Shqipërinë mes aleatëve të saj ushtarakë e strategjikë.

Nëse do të jepnit një këshillë për studentët tuaj, cila do të ishte ajo?

Këshilla që u jap gjithmonë është të vlerësojnë mundësinë që u është dhënë, si dhe të marrin e të japin maksimumin e tyre çdo ditë. E vetmja gjë që nuk kthehet pas është koha, prandaj duhet ta shfrytëzojnë atë me zgjuars. Jini të disiplinuar, të keni kuriozitet të vazhdueshëm dhe të mësoni jo vetëm për notat, por për veten dhe të ardhmen tuaj. Disiplina ju ndihmon të arrini qëllimet, edhe kur motivimi mungon. Konsistenca dhe puna e vazhdueshme sjellin suksesin afatgjatë. Kurioziteti ju bën të mësoni jo vetëm për atë që kërkohet në provime, por edhe për të kuptuar botën dhe për të zhvilluar aftësitë tuaja kritike. Mësimi për veten ju ndihmon të kuptoni se çfarë ju motivon dhe si mund ta përdorni dijen për të ndërtuar një karrierë dhe një jetë me kuptim. Në fund të fundit, sukcesi nuk matet vetëm me nota, por me aftësinë për të menduar, për të zgjidhur probleme dhe për t'u përmirësuar vazhdimisht. Një student i përgatitur sot është një ushtarak në karrierë, në të ardhmen.

Faleminderit për këtë bisedë frymëzuese!



GRUAJA USHTARAKE, LUFTËTARJA E PAEPUR E SFIDAVE TË KOHËS

Të qenit një grua ushtarake nuk është vetëm një profesion, por një mënyrë jetese që kërkon sakrificë të mëdha. Për një grua që është njëkohësisht ushtarake, bashkëshorte dhe nënë, balancimi i përgjegjësiwe familjare dhe detyrimeve të shërbimit bëhet një sfidë e përditshme.

Forca dhe Përkushtimi

Një grua që shërben në Forcat e Armatosura duhet të jetë e fortë fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht. Përveç përballjes me sfida profesionale, ajo duhet të gjejë forcën për të qenë edhe një mbështetje për familjen e saj. Kjo kërkon organizim të shkëlqyer, durim dhe mbështetje nga bashkëshorti dhe të afërmit.

Si Bashkëshorte

Një grua ushtarake përballlet me mungesa të gjata në familje për shkak të trajnimeve, misionëve ose dislokimeve jashtë vendit. Duhet të ruajë një komunikim të fortë me partnerin, edhe kur është larg. Ka nevojë për një bashkëshort mbështetës, i cili e kupton dhe e respekton angazhimin e saj profesional. Balancimi i rolit mes punës dhe jetës bashkëshortore mund të jetë sfidues, por me mirëkuptim dhe mbështetje, çdo pengesë mund të kapërcehet.

Si Nënë

Rritja e fëmijëve ndërkohë që shërben në ushtri është një sfidë e madhe. Ndjenja e mungesës është një nga vështirësitë më të mëdha, sidomos kur detyrohet të qëndrojë larg shtëpisë për periudha të gjata. Fëmijët e shohin si model frymëzimi, sepse ajo u tregon me shembullin e saj çfarë do të thotë guxim, disiplinë dhe përkushtim ndaj detyrës. Duhet të menaxhojë kohën me fëmijët në mënyrë cilësore, për të kompensuar momentet kur nuk është pranë tyre.

Sfidat dhe Sakrificat



Orari i gjatë dhe i paparashikueshëm mund të ndikojë në jetën familjare. Rreziku që vjen nga ky profesion mund të jetë një burim shqetësimi për familjen. Përballja me paragjykimet dhe pritshmëritë tradicionale mbi rolin e gruas në familje dhe shoqëri.

Forca e Gruas Ushtarake

Pavarësisht sfidave, një grua që është njëkohësisht ushtarake, bashkëshorte dhe nënë përfaqëson forcën, vendosmërinë dhe frymëzimin. Ajo dëshmon se një grua mund të jetë e zonja në çdo fushë të jetës, pa u kufizuar nga stereotipat.

Me mbështetje nga familja, një organizim të mirë dhe një zemër të fortë, një grua mund të përmbushë me sukses të dyja misionet: të mbrojtë vendin e saj dhe të ndërtojë një familje të shëndetshme dhe të lumtur.

Gruaja Ushtarake: Përballja me Paragjykimet dhe Pritshmëritë Tradicionale

Në një shoqëri, ku roli i gruas ka qenë historikisht i lidhur më shumë me familjen dhe kujdesin për shtëpinë, një grua që zgjedh të jetë ushtarake shpesh përballlet me paragjyime dhe pritshmëri tradicionale. Megjithatë, përmes forcës, profesionalizmit dhe përkushtimit, ajo mund t'i sfidojë këto mentalitete dhe të provojë se gratë janë po aq të afta sa burrat në mbrojtjen e atdheut.

Paragjykimet Kryesore që Përballlet një Grua Ushtarake

“Ushtria është vetëm për burra”. Ky është një nga mitet më të zakonshme. Megjithatë, historia ka treguar se gratë kanë shërbyer me sukses në forcat e armatosura në shumë vende të botës.

“Një nënë nuk mund të jetë një ushtarake e mirë”. Shumë mendojnë se një grua nuk mund të balancojë detyrimet ushtarake me përgjegjësitë e të qenit nënë, por ka shumë gra që kanë treguar të kundërtën.

“Gratë nuk janë aq të forta sa burrat”. Ndërsa biologjikisht burrat mund të kenë avantazhe fizike, gratë kompensojnë këtë me qëndrueshmëri mendore, disiplinë dhe aftësi taktike.

“Një grua ushtarake nuk mund të jetë një bashkëshorte e mirë”. Ideja që një grua duhet të jetë gjithmonë e pranishme

në shtëpi për të qenë një bashkëshorte e mirë është e vjetruar. Në një marrëdhënie të shëndetshme, mbështetja reciproke është më e rëndësishme se sa pranimi i roleve tradicionale.

Sfida dhe Lufta Kundër Stereotipave

Përballja me skepticizmin në punë. Shpesh, gratë ushtarake duhet të punojnë dyfish më shumë për të dëshmuar aftësitë e tyre dhe për të fituar respektin e kolegëve të tyre meshkuj.

Menaxhimi i balancës mes punës dhe familjes, ndonjëherë, presioni shoqëror bën që gratë të ndihen fajtoresh për zgjedhjet e tyre profesionale, por mbështetja nga partneri dhe familja është kyçe për të përballuar këtë sfidë.

Çdo grua që zgjedh të ndjekë një rrugë të ndryshme nga normat tradicionale bëhet një frymëzim për të tjerët.

Si Mund të Sfidohen Pritshmëritë Tradicionale?

Duke treguar përkushtim dhe aftësi profesionale, në mënyrë që të fitohet respekti përmes punës dhe suksesit; Duke folur hapur për sfidat, për të ndërgjegjësuar shoqërinë mbi realitetin e grave në ushtri; Duke mbështetur njëra-tjetrën, për të krijuar një kulturë të re, ku gratë ushtarake nuk shihen si përjashtim, por si pjesë normale e forcave të armatosura; Duke edukuar brezat e rinj, për të ndryshuar mentalitetin që nga fëmijëria dhe për të nxitur barazinë gjinore. Gruaja ushtarake nuk është thjesht një profesioniste e disiplinuar, por edhe një simbol i forcës dhe ndryshimit shoqëror. Ajo përfaqëson një brez të ri grash që nuk pranojnë të kufizohen nga pritshmëritë tradicionale, por që luftojnë për ëndrrat e tyre dhe për një botë ku talenti dhe aftësia vlerësohen më shumë se gjinia.

Gruaja ushtarake nuk është vetëm një luftëtare në fushën e betejës, por edhe në luftën kundër stereotipave shoqërore!





MISIONI HARTOGRAFIK DHE GJEODEZIK I IGJI-SË, MISION KOMBËTAR

Shqipëria ka një datë me shumë domethënie në historinë e saj, ndoshta që prej Pavarësisë. Dhe kjo ka të bëjë me gjeodezinë. Gjeodezia në Shqipëri zë fill në vitet 1918 dhe vijoi deri në 1927 me punimet e Institutit Gjeografik të Vjenës. Më 17 shtator 1927, u krijua grupi i parë gjeodezik me 13 specialistë. Detyra e këtij shërbimi ishte plotësimi i nevojave të ushtrisë me harta dhe materiale hartografike, organizimi i përgatitjes topografike të ushtarakëve, sigurimi i bazamentit të nevojshëm gjeodezik për nevoja të ushtrisë etj.

Më 10 gusht të vitit 1965, u shtyp e para hartë shqiptare
Instituti do të hartonte politika të grumbullimit, përpunimit, mirë-administrimit të informacioneve gjeografike dhe të gjeo-sistemeve në shkallë vendi. Ai organizonte përgatitjen topogjeodezike të terrenit shqiptar, përgatitjen e literaturës topografike e gjeografike ushtarake për armët dhe shërbimet e ushtrisë, do të planifikonte të gjithë punën për përgatitjen topografike të kuadrove dhe efektivave të strukturave të forcave të armatosura, për planëzimin dhe krijimin e rezervave të nevojshme me harta topografike dhe tematike apo speciale, si dhe do të ideonte dhe organizonte punën studimore, shkencore në fushat përkatëse.

Në vitin 1983 krijohet seksioni shkencor i Institutit me detyrë kryesore projektimin dhe pjesërisht zbatimin e detyrave topogjeodezike e hartografike. Ky seksion në vitin 1992 mori emrin Bordi Shkencor e më vonë në vitin 2001 u quajt Departamenti Kërkimor dhe i Projekteve.

Një ndër arritjet më kryesore e më të rëndësishme të Institutit është krijimi i Rrjetit të ri gjeodezik të Shqipërisë, i cili përfundoi në vitin 1986. Në vitin 1994 u nënshkrua marrëveshja midis këtij instituti dhe Agjencisë hartografike të SHBA-së. Qëllimi i saj është sigurimi i një ndihme teknike për bashkëprodhim dhe shkëmbim të ndërsjellë të hartave dhe informacioneve detare dhe ajrore, gjeodezike dhe gjeofizike, për arritjen e detyrave me karakter kombëtar për të dy institucionet. Projekti më kryesor i bashkëpunimit me palën amerikane ishte përtëritja e hartave topografike sipas standardeve të reja të NATO-s. Ky projekt përfundoi në vitin 2001. Në tetor të vitit 1994 u kryen fushatat e para të matjeve me GPS. Rezultatet e matjeve u shfrytëzuan për përgatitjen e një programi për llogaritjen e bazës matematike të hartave të reja.

Arkivi tekniko - shkencor i krijuar pranë Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake përbën një pasuri unike kombëtare. Ai mbart një kronikë hartografike të Shqipërisë, që nuk mund të gjendet në asnjë institucion tjetër historik-hartografik të vendit. Në Arkivin gjeo-hartografik të IGJU janë regjistruar, ruhen dhe administrohen të gjitha studimet, projektet, matjet e prodhimet me karakter hartografik, gjeodezik, gjeografik, topografik, fotogrametrik të kryera në vite, aerofilmat, filmat (negativë dhe pozitivë), planet dhe projektet e veprave të infrastrukturës.

Materialet që vihen në dispozicion të institucioneve shtetërore e private, studiuesve e kërkuesve, studentëve dhe qytetarëve të thjeshtë:

Kopje të hartave të vjetra me rëndësi historike kombëtare të shfrytëzuara kryesisht nga studiuesit, kërkuesit por edhe qytetarët e thjeshtë për probleme pronësie: Harta të kufirit të hartuara nga Komisioni i Kufijve, harta austriake, harta italiane, harta ruse, harta topografike të përpiluara dhe botuara nga IGJIU ndër vite, harta tematike, harta e Tiranës, harta e metropolit, harta rrugore e Shqipërisë, harta e Kosovës, harta detare, Gjiri i Durrësit, Gjiri i Vlorës, Spille-Radhimë, Radhime-Kepi i Stillos, Gryka e Bunës - Kepi i Lagjit.

Pika të rrjetit të triangulacionit dhe nivelacionit shtetëror të klasit I, II, III
Hartat sipas standardeve të NATO-s të shkallës 1:50.000, 1:25.000 dhe 1:10.000 janë hartuar dhe prodhuar vetëm për përdorim brenda strukturave të Forcave të Armatosura.
Një pushtim tragjik kryhet këto ditë nga Federata e Rusisë ndaj Ukrainës. Janë hapësira, vepra urbane, qytete që pushtohen. Përpara se të kryhej ky akt është përtërirë harta



topografike, është studiuar hapësira tokësore detare dhe ajrore, me sisteme koordinatash që përdoren nga të dy palët. Kjo na sjell në mendim, se sa vlerë kanë studimet e IGJI-së për ta ushqyer Shtabin e Përgjithshëm me harta dhe koordinata, dhe informacione të tjera që i duhen veprimeve luftarake.

Hartat e botës që nga shekulli IV p.e.s. ato të Herodotit, Hekatu-t Eratostenit, Strabonit dhe Ptolemeut, bartin në vete dhe trajtat e Ilirisë së hershme dhe vend-pozicionimin e Ilirëve. Historia që vjen e bart këtë portret me qëndresën aq të njohur të Ilirëve në hartat Romake, Arabe, Portulane, ndër hartat e Periudhës së Re, kur kontributet hartografike dhe gjeodezike erdhën nga pushtuesit, ndaj kemi gjurmët e Institutit Gjeografik të Vjenës, Institutit Gjeografik Ushtarak të Firences që realizuan studimet dhe hartat e para topografike.

Në Periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, sërish në fatin e ndikimeve të sistemit komunist që u vendos, kur Bashkimi Sovjetik u shtri si një Perandori Komuniste. Hartat gjatë kësaj periudhe sollën standarde të reja, ku për herë të parë morën pjesë edhe hartografët dhe Gjeodetët e parë të Shqipërisë. Më 2 prill 1946, fillon organizimi i Shërbimit Gjeodezik të Ushtrisë Popullore. Më vonë krijohet dhe vepron Detashmenti Autonom Topografik i Shtabit të Përgjithshëm që kreu disa detyra të rëndësishme gjeo-topografike.

Me vendim të Këshillit të Ministrave, më datën 8.05.1975, krijohet Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU). Ai kishte detyrë dhe mision kombëtar që të hartografonte Republikën e Shqipërisë në shkallë të mesme dhe të vogël, me vlera në fushën e Mbrojtjes së vendit dhe të zhvillimit ekonomik shoqëror e kulturor të Shqipërisë. Ai do të kishte si detyrë bazë nga ana studimore të ndërtonte Rrjetin Gjeodezik Shtetëror si dhe do të kishte edhe monopolin e Fotografimit Ajror. Kjo nuk është thjesht një histori. Është një ngjarje që nuk sjell vetëm një datë të thjeshtë të një Instituti të zakonshëm. Kjo ngjarje sjell në histori për një nga Institutet më në zë të fushës studimore dhe krijuese në Shqipëri, sepse ky Institut është marrë dhe merret me Hartën e Shqipërisë, me portretin e saj në kohë dhe hapësirë, me gjeo-historinë e këtij vendi që nuk i shërben vetëm ushtrisë por gjithë spektrit zhvillimor shqiptar.

Nismëtarët e tij të parë ishin: Dhimo Dhaskali, Limos Alimuçi, Vait Tartari, Çesk Begu, Thimi Jorgaxhi, Myslim Haxhiu, Filip Marga, Mulla Mullaj, të cilët ishin ndër kryesorët që punuan në këtë projekt të ri që do t'i vlente ardhmërisë së këtij shërbimi. Po nuk mund të harrohen edhe shumë të tjerë që punonin në sektorët e krijuar dhe dhanë mendime të çmuara. Ky Institut do të ishte institucion ushtarak kërkimor dhe prodhues, në fushën e përgatitjes topografike të ushtrisë shqiptare dhe më gjerë.

Më 15 mars 1975, u caktuan drejtori dhe zëvendës drejtori: Limos Alimuçi dhe Vait Tartari. Pas tyre vinte një bashkësi kuadrosh oficerë të shkallëve dhe të breznive të ndryshme, të cilët kanë lënë jetën e tyre në vlera të mëdha hartografike dhe vepra që s'harrohen si: Perlat Gjoliku, Robert Hajro, Kleanthi Dhimitri Çarçan Danaj, Novrus Xhaferi, Xhavit Xhani, Gani Mustafa, Vangjel Gaçe, Niko Zheku, Beniamin Lohja, Agim Mezini, Seit Shaplo, Hasan Dyli, Zeqo Zano, Bilbil Mehmeti, Hysen Dervishi, Liliana Duri, Marjeta Pasko e të tjerë. Më pas vjen një brezni tjetër kuadrosh që mbaruan shkollat ushtarake brenda vendit dhe u arsimuan edhe në Universitetin e Tiranës: Përparim Likaj, Maksimilian Gjika, Eduart Isufi, Stafan Shahini, Asllan Muka, Piro Dado, Bajram Muja, Ptoleme Biku, Asllan Bebeçi, Kostandin Premti e shumë të tjerë që mbushën kontributet teknike e kërkimore në fushat inxhinierike. Po kështu një bashkësi e tërë kuadrosh topografë nga shkollat ushtarake zunë pozicione të rëndësishme në Institut si në Astronomi, Gjeodezi, Hartografi si Asllan Gorezi, Llukan Mici, Vladimir Koruni, Asim Beja, Josif Kollçi, Mustaf Koçerri, Kujtim Ago. Një brezni e më këndejme do të vinte me Çelik Muratin, Behar Malaj, Bashkim Çapunin, Faik Teki Meta, Osman Tome.

Misioni hartografik dhe gjeodezik i IGJI-së është mision kombëtar

“Mision” që nuk lidhet nga politika dhe ideologjia. Është ana shkencore dhe teknike që ka themel. Nëse ka diçka që duhet t'u thuhet me lavde brezave që shkuan dhe që ndërtuan ITU-në, është se ata panë në rrënjë “Misionin topografik dhe gjeodezik” dhe për këtë do të ngelen në histori. Brezat që erdhën e gjetën këtë udhë të hapur. Kjo duhet thënë me plot gojën. Rrallë mund të ketë ndodhur që në kushte të izolimit komunist të ndërtoheshin vepra aq të mëdha kombëtare se sa rrjeti Gjeodezik Shtetëror, se sa hartografimi në të gjithë shkallët (1: 10 000, 1: 25 000. 1: 50 000 deri në 1: 1000 000) vepra të vlerësuar nga ana shkencore dhe teknike gjer në ditë të sotme. Ka qenë një energji e jashtëzakonshme. Pa këtë bazë nuk do të kish arritur kulme dhe nuk do të kish patur një Institut Gjeografik Ushtarak, i cili të përballej me kërkesa të reja të zhvillimeve postkomuniste. Është një periudhë e gjatë, e trazuar, me zigzage, të cilat kulmuan në vitin 97, kur ky institut u gjend në prag të shfarosjes dhe djegies makabre. Por u arrit që të shpëtohej, ndërkaq ishte në pikëpyetje e ardhmja e tij.

Nuk është e lehtë që të jesh në hullinë e informacioneve moderne si dhe të teknologjive. Shqipëria të gjithë projektet zhvillimore të saj i ka bërë dhe po i bën në bazë të hartografimit dhe të gjeodezisë themelore që ka kryer ky institut. Nuk është pak të shndërrosh sistemin gjeodezik, të kalosh në harta të standardeve të NATO-s në Sistemit të Pozicionimit Global të bashkëpunimit me institucione të huaja. Këto janë vlera që janë pranuar nga partnerët ndërkombëtarë. Ky është një realitet krenarie, sigurisht. Misioni që ka Instituti lidhet me informacionet hapësinore, e këtu buron ai kujdes inteligjent që duhet qysh në krye të veprave dhe Projekteve. Nuk mund të harrohet asnjëherë Marrëveshja e Delimitimit të Detit midis Greqisë dhe Shqipërisë në vitin 2009! Ajo që ndodhi është dramatike.

Tani Instituti quhet: “Instituti Gjeografik dhe i Infrastrukturës”, gjeografia luan rolin e saj të madh vetëm atëherë kur rojat hartografike kombëtare janë në krye të orientimeve zhvillimore të reformave të sotme jo vetëm në FA por edhe për gjithë vendin. Në histori dhe në përvojë, Lufta e Kosovës ishte në kreun e ndihmesës së madhe hartografike dhe gjeodezike në studimin e hapësirës së Republikës së Kosovës. Projekti i parë që u krye me NIMA (National Imagery and Mapping Agency) e SHBA-së, përtëritja e hartave topografike të shkallës 1:50 000 sipas standardeve të NATO-s. Me një vendim të posaçëm të KM dhe ligjin për Institutin prej Parlamentit të Shqipërisë, u bënë ndryshime me rëndësi për Misionin. Instituti u quajt Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë.



Kosova shënon 27-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. 27 vjet më parë, më 5-7 mars 1998, në Prekaz ndodhi një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë, e quajtur “Epopeja e UÇK-së”, histori e krahasueshme me kolosët heroikë të lashtësisë, princërit dhe kalorësit e mëdhenj të mesjetës, si dhe me strategët e famshëm të historisë moderne! Epopeja e UÇK-së e udhëhequr nga Adem Jashari ndërgjegjësoi mbarë botën liridashëse dhe demokratike për fatin e një populli të shtypur që nuk dorëzohet kurrë. Kjo ngjarje e shënuar në historinë e Kosovës, mori karakterin e një ngjarjeje si krenare por edhe pikëlluese. Dhimbja dhe indinjata u kthyen në një forcë të re mobilizuese në luftën për çlirim që tani nuk kishte të ndalur...

Sulmi mbi Prekaz ose Masakra e Prekazit ishte një sulm i kryer nga Policia e Serbisë (MUP) dhe nga Njësia Speciale Serbe (SAJ) më 5-7 Mars 1998, për të kapur luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët janë konsideruar si “terroristë” nga Serbia.

Gjatë sulmit, komandanti i UÇK-së, Adem Jashari dhe vëllai i tij Hamëz Jashari u vranë së bashku me afro 58 anëtarë të tjerë të familjes. Sulmi u kritikua nga Amnesty International, e cila shkruante në raportin e saj se: “të gjitha provat sugjerojnë se sulmi nuk kishte për qëllim kapjen e shqiptarëve të armatosur, por eliminimin e të dyshuarve dhe familjeve të tyre”. Serbia, nga ana tjetër, pretendoi se bastisja ishte për shkak të sulmeve të UÇK-së në postet e policisë. Adem dhe Hamëz Jashari ishin anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), një organizatë guerile e shqiptarëve etnikë që kërkonin pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia. Adem Jashari ishte përgjegjës për organizimin e formacionit të parë të armatosur politik në Skënderaj, në vitin 1991. Duke ndjekur Adem Jasharin për vrasjen e 1 polici serb, forcat serbe u përpoqën përsëri të sulmonin kompleksin e Jasharëve në Prekaz, më 22 janar 1998.

Më 28 shkurt 1998, shpërtheu një përleshje zjarri midis luftëtarëve shqiptarë dhe një patrulle të policisë serbe në fshatin e vogël Likoshan. Katër policë serbë u vranë dhe disa u plagosën. Luftëtarët e UÇK-së, njëri prej të cilëve edhe Adem Jashari, kanë shpëtuar. Më pas, policia serbe vrau 13 civilë shqiptarë në një shtëpi aty pranë. Më vonë po atë ditë, policët serbë e sulmuan fshatin fqinj Qirezin dhe më pas i vranë 26 shqiptarë, luftëtarët shqiptarë arritën të arratiseshin dhe policia vendosi ta sulmonte Adem Jasharin dhe familjen e tij. Në luginën e Drenicës, Adem Jashari vendosi të qëndrojë në shtëpinë e tij dhe i porosi luftëtarët e tij që të qëndrojnë atje po ashtu dhe të rezistojnë deri në njeriun e fundit.

Operacioni

Më 5 mars 1998, UÇK-ja ka hedhur një sulm në patrullën e policisë në Prekazin e Ulët që shkaktoi policinë serbe të kërkojë ndëshkim, sipas raporteve publike të Serbisë. Pas sulmit të dytë, policia u përgatit për përgjigjen brutale ndaj

27 VJET NGA EPOPEJA E UÇK-SË

familjes Jashari. Ata filluan të gjuanin ushtarët lokalë të UÇK-së, të cilët u detyruan të tërhiqen në kompleksin e Jasharit në të njëjtin fshat.

Policët jugosllavë rrethuan grupin dhe i ftuan ata që të dorëzoheshin, duke u bërë thirrje të gjithë personave të tjerë për të pastruar lokalet. Policia më tej pohoi se ata u dhanë dy orë për t’u pajtuar. Brenda afatit të caktuar, dhjetëra civilë u pajtuan me rendin dhe u shpërndanë në siguri nga kalaja. Sipas policisë, pas skadimit të afatit prej dy orësh, Adem Jashari, vëllai i tij dhe pjesa më e madhe e anëtarëve të familjes së tij, megjithatë refuzoi të pajtohet dhe të mbetet brenda kompleksit.

Pas një qëndrimi verbal të tensionuar, sipas deklaratave zyrtare serbe, grupi i Jasharit u përgjigj duke gjuajtur policinë me armë automatike, mortaja, granata dore dhe snajper, duke vrarë 2 dhe plagosur 3 policë. Në dhunën pasuese, policia jugosllave vrau më shumë se 60 vetë, duke përfshirë edhe vëllezërit Jashari. E vetmja që mbijetoi ishte Besarta Jashari, vajza e Hamëz Jasharit.

Ajo pretendonte se policët e kishin “kërcënuar me thikë dhe e urdhëruan të thoshte se xhaxhai i saj (Adem Jashari)

“

MASAKRA E PREKAZIT ISHTE NJË SULM I KRYER NGA POLICIA E SERBISË (MUP) DHE NGA NJËSIA SPECIALE SERBE (SAJ) MË 5-7 MARS 1998, PËR TË KAPUR LUFTËTARËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (UÇK-SË), TË CILËT JANË KONSIDERUAR SI “TERRORISTË” NGA SERBIA. GJATË SULMIT, KOMANDANTI I UÇK-SË, ADEM JASHARI DHE VËLLAI I TIJ HAMËZ JASHARI U VRANË SË BASHKU ME AFRO 58 ANËTARË TË TJERË TË FAMILJES.

kishte vrarë të gjithë ata që donin të dorëzoheshin”. Goran Radosavljević, një nga drejtuesit e Ministrisë së Brendshme të Serbisë, deklaroi se “Adem Jashari i kishte përdorur gratë, fëmijët dhe të moshuarit si pengje...”.

Gjenerali i Ushtrisë Jugosllave Nebojsa Pavković deklaroi se: “Ishte një veprim normal policor kundër një kriminelit të njohur, ishte i suksesshëm. Detajet e tjera nuk i kujtoj”.

Dëshmitë e mbledhura më vonë treguan se sulmi nuk kishte për qëllim të kapte ushtarët e armatosur shqiptarë; Përkundrazi, sulmi ishte për t’i eliminuar ata dhe familjet e tyre.

Shtëpitë e tjera të anëtarëve të familjes Jashari u sulmuan gjithashtu nga policia si dhe kompleksi rezidencial i familjes Lushtaku.

Këshilli i sigurimit i OKB-së u kthye në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara pa autorizuar masën përfundimtare të kapitullit që ishte ndërhyrja ushtarake.

Të shtënat në kompleksin e familjes Jashari, ku përfshihej Adem Jashari, komandant i UÇK-së dhe përreth trupat jugosllave në vitin 1998, rezultoi në masakrën e shumicës së anëtarëve të familjes Jashari.

Vdekja e Jasharit dhe familjes së tij shkaktoi një reagim ndërkombëtar kundër Republikës Federale të Jugosllavisë. Sulmi i Prekazit çoi në një rritje të shpejtë të popullaritetit të UÇK-së në mesin e shqiptarëve etnikë dhe milicëtë e fshatrave u formuan në shumë pjesë të Kosovës.

Ndërsa lajmet për vrasjet u përhapën, milicëtë e armatosura shqiptare të Kosovës u shfaqën në mbarë Kosovën, duke kërkuar të hakmerreshin për vdekjen e Jasharit, ndërsa shqiptarët dyndeshin për t’iu bashkuar UÇK-së.

Ngjarja u bë një thirrje tubuese për rekrutimin e UÇK-së në lidhje me rezistencën e armatosur ndaj forcave jugosllave. Pas ngjarjes, vetë Adem Jashari u portretizua si “terrorist” në mediat jugosllave, ndërsa mediat shqiptare e përshkruanin “luftëtar lirie”. Viktimat e sulmit do të cilësoheshin si rënia e “dëshmorëve” në mediat shqiptare, ndërsa në mediat serbe raportoheshin si “efekte kolaterale të luftës kundër terrorizmit”. Më 13 mars, rreth 50.000 njerëz demonstruan kundër sulmeve, ndërsa më 15 mars, Kisha Katolike bëri thirrje që të mbahen mesha në të gjithë rajonin, pas së cilës rreth 15.000 njerëz demonstruan në Prishtinë.

Në fund të marsit 1998, më shumë se 100.000 njerëz marshuan në 8 qytete amerikane dhe kryeqytetet evropiane për të protestuar kundër sulmit.

Përfundimisht, ngjarjet dolën jashtë kontrollit dhe pasoi Lufta e Kosovës.



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Ashtu si ndaj prindërve, edhe ndaj mësuesve borxhi mbetet përjetë i pashlyer dhe nderimi mbetet përjetë i thellë, i pafund. Ndërsa bisedoja me disa shokë në Tiranë, Europë dhe SHBA për idenë e këtij shkrimi, puna doli e vështirë që në fillim, për cilët nga mësuesit të shkruajmë? Për Avdi Xhuglinin, mësuesin tonë të mrekullueshëm të rusishtes, që e kishim edhe kujdestar në vitin e parë të shkollës? Po e meriton të shkruash për të, për dashurinë dhe kujdesin e pamat të tij ndaj nxënësve, për dhembshurinë dhe butësinë, për këshillat prindërore, për interesimin tek mësuesit e tjerë, për gjithçka të mirë që na mësoi në atë vit, padyshim më të vështirin për çdo skënderbegas. Apo të shkruajmë për Jorgji Konën, inxhinierin dhe sportistin e talentuar, Mjeshttrin e Merituar, aq i rregullt, aq i përgatitur, por sidomos aq i sjellshëm, si një zotni i vërtetë!

Për Sami Bogdanin, me atë stilin e vrullshëm e origjinal të të shpjeguarit, apo për tre miqtë e tij, Bujar Llagamin, Isak Mezinin dhe Petraq Ikonomin?

Për të ëmblën Zibo Gjomema apo për të rreptin por të drejtin, të mençurin dhe ironikun Vladimir Bitri, që aq shumë na desh e na ndihmoi në dy vitet e fundit të shkollës, jo vetëm si mësues i matematikës, por edhe si mësuesi ynë kujdestar. Është padyshim merita e tij më e madhe që ato dy vite asnjë nga toga jonë nuk ngeli në klasë, dhe njëherësh toga jonë e 4/6 ishte nga më të mirat, jo vetëm në mësim, por edhe në veprimtaritë e tjera, kulturore, artistike e letrare, sportive etj. Për Ana Priftin, Ali Nevirin, Vitorinë, Yllin, Asimaqin, Pavlin, Metin, Sotirin, Spartakun, Hasanin, Shabanin... Epo si i thonë, pyet 100 vetë e bëj si di vetë, duke shprehur nderimin më të madh për të gjithë, pa përjashtim, po shkruaj pak më gjatë për tre mes tyre.



Skënder Shkupi

I ditur. Shumë i ditur. Mbase mësuesi me njohuritë më të gjera e më të thella mes kolegëve. Jo vetëm në fushën ku kishte studiuar, në matematikë-fizikë, por besonim se profesor Skënderi ishte i gjithë-formuar edhe në shkencat e tjera, në histori p.sh, apo në gjuhësi dhe letërsi. Vite më vonë, kur shkoi në redaksinë e Revistës “Shkenca dhe Jeta”, profesor Skënderi, me nivelin e lartë të shkrimeve, jo vetëm atë shkencor, por edhe letrar e gazetaresk, shpalosi gjithë njohuritë e tij të gjera e të thella. Të linte një përshypje të këndshme që në paraqitje, gjithnjë i veshur bukur dhe me shije, por edhe kur fliste e shpjegonte. Asnjëherë nuk e pamë e dëgjua më ngrinte zërin, gjithnjë me atë buzëqeshjen e këndshme e disi ironike në fytyrën e bukur, asnjëherë nuk bëri ndonjë bisedë ashtu, kot. Një aristokrat i vërtetë! Në paraqitje dhe në mendime e veprime!

Ishte metodist i përkryer në shpjegim. Ne na ka dhënë lëndën e Astronomisë në vitin e katërt. Ishin 40 orë gjithsej. Profesor Skënderi shpjegoi 39 orë. Shpjegoi?! Jo, ai bëri art, art në kuptimin më të plotë të fjalës. Sa hynte në klasë, linte regjistrin mbi tavolinë, merrte shkumësin, - ne përgatisnim një tufë shkumësash me ngjyra të ndryshme, - dhe shkruante e vizatonte duke filluar nga cepi i majtë lart i dërrasës së zezë, e kur binte buria në mbarim të 45-minutshit, ai vinte pikën e fundit në cepin e djathtë poshtë të saj. Merrte regjistrin, përshëndeste dhe prapa linte, siç thashë, një vepër të vërtetë arti. Një shkrim i bukur, i shoqëruar me figura të rregullta, të lexueshme, funksionale. Nuk përdorte vizore, por vijat e bëra me dorë për të ndërtuar trekëndëshat, katrorët etj., ishin mbase më të drejta se me vizore. Nuk përdorte kompas, por figurat rrethore e elipsore, Toka, Hëna, planetët, gjithë sistemi diellor, galaktikat, ishin në dërrasën e

NËSE DO TË KRIJONI STATUJA PËR NJERËZ TË RËNDËSISHËM, KRIJOJINI PËR MËSUESIT! ATA JANË HERONJ TË SHOQËRISË TONË

zezë si të fotografuar. Referencat te Plutoni apo Arkimedi, Koperniku, Galileu apo Njutoni, Gausi e Ajnshtajni e të tjerët i bënte me lehtësinë më të madhe, i shpjegonte thjesht e kuptueshëm. Shkurt, ka qenë një kurs leksionesh i këndshëm. Profesori na krijoi një pamje vërtet të plotë dhe fantastike të sistemit Diellor e të galaktikave, me shumë informacion e kuriozitete. Dhe plus këtyre, na mësoi me shembullin e tij seriozitetin dhe përgjegjësinë kur del e flet para të tjerëve. Ne do të bëheshim një ditë komandues, dhe ky shembull ishte një leksion i madh, shumë i rëndësishëm. Dhe mësimi tjetër për ne, kuadrot e ardhshëm, ishte domosdoshmëria për të zgjeruar njohuritë, lexuar e studiuar tej rregulloreve e manualeve ushtarake. Dhe shembullin prapë na e jep edhe sot: siç tha në një emision televiziv, ai prapë, edhe pse në moshë të thyer, lexon, studion, shkruan.

E pra, ajo që u thuhet e kërkohet aq shumë ushtarakëve, të udhëheqin nëpërmjet shembullit, te profesor Skënder Shkupi mbase gjen shprehjen më të bukur, më të përsosur. Prandaj profesor Shkupi është një nga më të dashurit e më të nderuarit për ne ish-skënderbegasit.



Sashenka Rino-Deli

Ti erdhe si qeshje mes nesh,
Si një fllad në mbrëmje pranvere,
Siç dielli derdh rrezet mbi gjeth,
Ti shpirtin e pastër e derdhe..., do të shkruaja në një poezi vite e vite më vonë, kur në vetminë e shërbimeve të shumta në repart, si të gjithë besoj, u kthehesha kujtimeve të Shkollës.

Do të fillonim vitin e dytë kur na thanë se lëndën e Letërsisë do të na e jepte një mësuese e re. E re? Kjo sikur na e hoqi pak mërzinë që s'do të kishim më profesor Ramzotin, me të cilin kaluam aq bukur vitin e parë. Myzaferi, një djalosh durrsak, i imët, pak i bezdisur nga uniforma ushtarake që u detyrua ta vishte pasi mbaroi studimet dhe u vu në dispozicion të MM, për ne ishte më shumë shok, edhe pse në orën e mësimit ishte i rreptë. Por kush na pyeste ne, ndaj me sytë nga dera prisnim të hynte mësuesja e re. Ajo hyri dhe në fytyrat tona u ndesh një buzëqeshje e lehtë, ishte jo vetëm e re, por edhe e bukur, shumë e bukur. Komandanti ynë i togës i raportoi gatishmërinë për orën e mësimit, mësuesja u ndje pak e bezdisur nga kjo gjë, tha një faleminderit nëpër dhëmbë dhe shkoi tek tavolina. “Mirë, - tha pasi u ulëm, - bashkë do bëjmë Letërsinë. Më quajnë Sashenka. Sot do flasim për...”, dhe hyri drejt e në shpjegim. Do të kalonin vetëm pak kohë dhe mësuesja jonë e re dhe e bukur e kuptoi se në klasën tonë nuk funksiononte sjellja strikt, ora e mësimit ishte e ngushtë për karakteret tona. Ajo pa se nga grupi, gati 10 prej nesh ishin një a dy hapa para programit dhe diskutonim e kërkonim diçka më shumë. Dhe na inkurajoi. Si? Duke dalë shpesh ajo vetë nga programi, duke na treguar e shpjeguar shumë më tepër se teksti. Na dha një mundësi të flasim e të debatojmë për libra e autorë që vërtet ishin në program, por duke u zgjeruar në tema dhe ide. Më kujtohet se mësuese Sasha na ka folur e para për simbolikën e Kadaresë dhe na nxitu të kërkonim e të kuptonim ç’ ishte “Kështjella” p.sh, ose pse në roman ai e quan Heroin tonë Kombëtar “Gjergji ynë”. Kjo na dha një shtysë që tash e mbrapa ta shihnim tekstin, librin në tërësi, ndryshe, të mendonim rreth tij, të kuptonim idenë, mesazhin e tyre. Ja një moment që na u kujtua në bisedat për këtë shkrim: I thamë mësueses se temën për Migjenin do ta shpjegonim vetë ne. Njëri do të fliste për jetën, tjetri për poezinë, i treti për prozën, i katërti për idetë dhe vendin e Migjenit në letërsinë shqipe, një tjetër do të recitonte... Pas një hesitimi të kuptueshëm, mësuesja pranoi.

Dhe ka dalë një dy-orësh vërtet i bukur, ku mësuesja sigurisht ndërhynte, shpesh dhe me humor dhe me atë të qeshurën e veçantë, të singertë, e qeshur zemre do të thosha, e pranoi që ishte një përvojë e bukur.

E pra, kjo ishte Sashenka, një mësuese që jo vetëm na mësoi Homerin, Danten, Hygoïn, Dikensin, Naimin, Nolin, Lasgushin, Xoxën, Dritëroin..., por dhe na dha lirinë të mendonim rreth tyre përtej tekstit. Në një nga urimet për datëlindjen, i kam treguar vajzës së saj: “Mami jot ishte kaq e lirë në të menduar, kaq e guximshme dhe e emancipuar!”.

Në një klasë me 30 djem të rinj, nën uniformë e disiplinë ushtarake, Sasha ishte si një cep me pak më shumë diell e ngrohtësi lirie e liberalizmi, prej saj kemi dëgjuar së pari për “prerjen e artë”!

Dhe tej letërsisë, mësuese Sasha na nxiste të dëgjonim muzikë, të shkonim në koncerte e madje dhe në opera, të shkonim në galeritë e artit, muzeume... Asaj i kemi treguar shkrimet tona, para se të shkonim te “Luftëtari”, “10 Korriku”, “Zëri i Rinisë” e madje dhe “Drita”. E për gjithçka të mirë që na dha e na mësoi, Sashenka Rino-Deli është dhe sot një nga më të dashurat për breza të tërë skënderbegasish!

Gëzuar 7 Marsin Mësuese! Dhe qofsh e qeshur gjithmonë! Sepse, siç e mbyll atë poezinë për ty:

Se vitet ikin, më s’vijnë
Ca plaken e ca mbeten vasha,
Por ti mos e lër rininë,
Të t’ ikë nga shpirti moj Sasha!



Besnik Kurshumi

